

## Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në botë

### Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut 06-12.01.2025

Janë testuar gjithsej 259 materiale në Laboratorët ku bëhen analiza molekulare për vërtetimin e pranisë së virusit SARS-CoV-2. Krahasuar me javën që shkoi (n=128) është shënuar një rritje prej 18,3%.

Janë regjistruar 6 raste pozitive, ngjashëm si javën që shkoi, përqindja e rasteve pozitive sillet nga 0,0% deri më 7,4%, mesatarisht 2,0%.

*Tabela 1. Numri i testimeve dhe rasteve pozitive në periudhën nga 06-12.01.2025*

Data	Testime	Pozitive	% e rasteve pozitive
06.1.2025	38	0	0,0%
07.1.2025	11	0	0,0%
08.1.2025	54	4	7,4%
09.1.2025	50	1	2,0%
10.1.2025	64	0	0,0%
11.1.2025	22	1	4,5%
12.1.2025	20	0	0,0%
<b>Gjithsej</b>	<b>259</b>	<b>6</b>	<b>Mesatarisht 2,0%</b>

Gjatë javës së kaluar të sëmurë janë regjistruar në 4 komuna, nga 2 në Kumanovë dhe Strumicë, dhe nga një në Shkup dhe Kërçovë. Të sëmurët bëjnë pjesë në dy grupmosha, 5 në grupmoshën mbi 60 vjet dhe 1 rast grupmoshës nga 40-49 vjet.

Gjatë javës së kaluar (06-12.01.2025) janë regjistruar si të shëruar 6 persona, ndërkohë që nuk është raportuar rast i vdekjes si pasojë e COVID-19.

### **GJENDJA ME COVID-19 NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT NË VITIN 2025**

Gjatë vitit 2025, deri më 12.01.2025, janë regjistruar gjithsej 11 raste me COVID-19. Në muajin dhjetor të vitit 2024 (6) regjistrohet një rënie prej 50% për dallim nga një muaj më parë.

Gjatë vitit 2025, deri më 12.01.2025, janë testuar gjithsej 425 materiale, në laboratorët në të cilët realizohen testime molekulare për prani të SARS-CoV-2 dhe në laboratorët / institucionet shëndetësore në të cilat bëhen testimet e shpejta antigjene.

### **Vlerësimi i rrezikut**

Shkalla e ulët e transmetimit të SARS-CoV-2, rënia e numrit të raportimeve dhe testimeve ndikon në aftësinë për vlerësimin e gjendjes epidemiologjike. Popullata e EU/EEA në përgjithësi ka një nivel të

konsiderueshëm të imunitetit hibrid (vaksinim/vaksinim me booster doza), që ofron një mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes.

Personat mbi 60 vjet janë më të rrezikuar nga pasqyra e rëndë e sëmundjes.

Hospitalizimi i personave me COVID-19 të konfirmuar, pranimet në kujdesin intensiv dhe vdekjet mbeten në nivel të ulët në vendet e BE-së. Këto të dhëna nuk janë të disponueshme në R. e Maqedonisë së Veriut.

Edhe pse numri i të sëmurëve me COVID-19 në javë po shënon rënie, duke pasur parasysh se fillon periudha e qarkullimit të shtuar të viruseve respiratore në hemisferën veriore, ekziston rreziku që aktiviteti i SARS-CoV-2 të rritet, gjë që e thekson nevojën e vazhdueshme për mbikëqyrje (epidemiologjike dhe virologjike) në nivel kombëtar dhe rajonal.

### **Masa të rekomanduara për parandalim dhe kontroll**

Rekomandohet ndjekja e masave themelore për parandalimin e COVID-19 dhe sëmundjeve të tjera respiratore.

Vaksinimi mbetet si masë specifike që mundëson mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes, edhe pse ky efekt mbrojtës me kalimin e kohës dobësohet. Mbetet rekomandimi për vaksinimin e personave me rrezik të lartë nga format e rënda të sëmundjes (siç janë personat më të moshuar).<sup>1</sup>

**Shkup, 13.01.2025**

**Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse**

**Instituti i Shëndetit Publik**

---

<sup>1</sup> <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/2024-WCP-0039%20Final.pdf>